



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:247244

Datë: 10.07.2024

Numri i dokumentit: 05921259

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Bekim Salihu, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditëses A.B. nga Ferizaj, të cilat me autorizim i përfaqëson Qendrim Reçica, avokat nga Lipjani, rruga “Gjergj Fishta, nr.44, kundër të paditurës Komuna Shtime - Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson Lulzim Muharremi, në çështjen juridike për pagesën e shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit nga marrëdhënia e punës, në seancën e mbajtur me datë 29.03.2024, merr ndërsa me 01.07.2024 përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses A.B. nga Ferizaj, si e bazuar.

II. DETYROHET e paditura Komuna Shtime - Drejtoria e Arsimit, që paditëses A.B., në emër të shpërblimit jubilar, kualifikimit dhe shpenzimeve të ushqimit nga marrëdhënia e punës, t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej **4,435.31€** (katërmijë e *katërqind e tridhjetë e pesë euro e tridhjetë e një cent*) dhe atë si në vijim:

a)- në emër të shpërblimit jubilar prej 50% të një page bazë prej 459.95€, apo shumën prej 229.97 € (*dyqind e njëzetë e nëntë euro e nëntëdhjetë e shtatë cent*);

b)- në emër të ushqimit për periudhën 23.11.2019 deri 21.11.2022, për 528 ditë puna nga dy euro apo shumën prej 1056.00 € (*njëmijë pesëdhjetë e gjashtë euro*);

c)- në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 70%, të biletës kthyesë nga data 23.11.2019 - 21.11.2022 për 528 ditë pune, në relacionin Ferizaj-Shtime dhe anasjelltas shumën prej 739.20€ (*shtatëqind e tridhjetë e nëntë euro e njëzetë cent*);

d)- në emër të diferencës në kualifikim për 27% të pagës bazë, për periudhën prej 23.11.2019 deri më 06.02.2023 shumën prej 2,410.34€ (*dymijë e katërqind e dhjetë euro e tridhjetë katër cent*);

III. OBLIGOHET e paditura që paditëses t'ia paguaj shumat e përcaktuar si në pjesën II të dispozitivit, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 269.20 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

IV. OBLIGOHET paditësja që të paguajë paraprakisht taksën gjyqësore për paraqitje të padisë në shumë prej 20.00 €, në afat prej 3 ditësh pas pranimit të kopjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

I autorizuari i paditësve gjatë shqyrtimit dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë Gjykatës i dorëzojmë parashtresën për precizimin e kërkesë padisë deri në kohën sa ka qenë në fuqi kontrata kolektive dhe lidhur me kualifikimin e bazjamë kërkesën në vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.01/33, të datës 29.08.2008, andaj nga provat e administruara vërtetohet themelësia e kërkesë padisë dhe i propozojmë gjykatës që në tërësi të aprovoj kërkesë padinë e precizuar, duke detyruar të paditurën që paditëses të i bej kompensimin si në petituimit të kërkesë padisë së precizuar, me kamatë ligjore dhe shpenzimet e procedurës kontestimore si në precizim të kërkesë padisë dhe atë për përpilim të padisë shumë prej 104.00 euro, si dhe një seancë të mbajtur shumë prej 135.00 euro dhe për taksë gjyqësore 40.00 euro, ku me to vlerësohet lartësia e saj, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga dita e parashtimit të padisë e deri në pagesën definitive, si dhe kompensimin e shpenzimeve të procedurës.

I autorizuari i të paditurës, në shqyrtim gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se edhe me tutje mbetet pranë përgjigjes në padi në të cilën kemi arsyetuar që padia dhe kërkesë padia janë të parashkruara, po ashtu edhe kontrata kolektive e arsimit e vitit 2021, me nuk është në fuqi. Për të gjitha këto arsye ne si palë e paditur konsiderojmë se padia dhe kërkesëpadia nuk kanë bazë ligjore. Nuk e kundërshtoj precizimin e padisë. Ka kërkuar nga gjykata që të refuzon kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar.

Gjykata, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, për aq sa palët ndërgjyqëse parashtruan ato, si obligim i tyre sipas nenit 7 par.1 të LPK-së, ka bërë administrimin e provave si në vijim: *Kontratat e punës, nr. ... datës 16.11.2023 në emër të A.B.; Vërtetim mbi përvojën e punës nga Gjymnazi "Naim Frashëri" nr.protokolli, dt.16.03.2022; Vërtetim mbi*

përvojën e punës nga Gjimnazi “Naim Frashëri ” nr.protokolli, dt.18.03.2022; Diploma e Universitetit Shtetëror i Tetovës nr....., dt.28.04.2010; Licenca e mësimdhënësit me nr.; Vërtetim për ditët e pranisë në punë Gjimnazi “Naim Frashëri” me nr., dt.26.03.2024; lista e pagave .

Gjykata, pasi bëri shqyrtimin dhe analizimin e provave të çështjes, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka bërë vlerësimin e tyre veç e veç dhe të ndërlidhura mes veti, si tërësi, dhe mbi bazën e bindjes së lirë të krijuar nga shqyrtimi i provave të çështjes, ka vlerësuar se duhej vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pasi që, për të paditurën, nuk ishte kontestues lartësia e kërkesëpadisë por baza juridike e saj, me qëllim të përcaktimit se kush është e obliguar të mbuloj kompensimet e cekura si në kërkesëpadi, gjykata ka analizuar dispozitat e Kontratës Kolektive në Arsim e dt.18.04.2017.

Sipas nenit 35 pika 7 e Kontratës Kolektive në Arsim, e vitit 2017, parashihet që: ***“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore.”***

Sipas nenit 35 pika 8 e Kontratës Kolektive në Arsim, e vitit 2017, parashihet që: ***“Punëtorët në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: për 10 vite të përvojës së punës në vlerë prej 50% të një page bazë; për 20 vite të përvojës së punës në vlerë prej 75% të një page bazë; për 30 vite të përvojës së punës në vlerë të një page bazë; për 40 vite të përvojës së punës në vlerë prej 150% të një page bazë...”***

Sipas nenit 46 të Kontratës Kolektive në Arsim, e vitit 2017, parashihet që: ***“MASHT dhe SBASHK angazhohen bashkërisht për të informuar dhe ndihmuar Komunitat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9”.***

Gjykata lidhur me kërkesën në emër të diferencës së kualifikimit ka vendosur si në pikën II-d, të dispozitivit të këtij Aktgjykimi dhe ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke u bazuar në nenin 7 të KKAK-së, e cila përcakton se: “Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të Punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shpëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi

bazën e kualifikimit dhe atë: 1.1 Mësimdhënës me Shkollë Normale 10 %t e pagës bazë; 1.2 Mësimdhënës me Shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare 19 % e pagës bazë; 1.3 Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27 % e pagës bazë; 1.4 Mësimdhënës me diplomë 4 vjeçar, magjistraturë/master dhe doktoraturë, 35 % e pagës bazë; 1.5 Përparimet në karrierë, caktohet lartësia e pagës dhe lëvizja në gradim që përcillet me një ngritje page 10 %.”. Në këtë kontekst, nga gjendja e vërtetuar faktike dhe juridike, nga provat e administruara në shqyrtim kryesor, gjykata ka vërtetuar se paditësja A.B., në emër të kualifikimit me fakultet, i takon lartësia prej 27 % të pagës bazë, ndërsa i është paguar shuma prej 60.50 euro, e që është dashur të paguhet 123,93 euro, çka do të thotë se e paditura ka hyrë në detyrim tek paditësja e parë për 38 muaj nga 63,43 euro, apo në shumë të përgjithshme prej 2410.34 euro;

Gjykata nga analizimi i dispozitave të cituar si më lartë, ka ardhur në përfundim se e paditura është e obliguar që paditësës t’ia paguaj shpenzimet e ushqimit dhe pagesën e shpërblimit jubilar dhe kualifikimit, konform dispozitave të Kontratës Kolektive në Arsim e vitit 2017 dhe vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.01/33, të dt.29.08.2008, të elaboruara si më lartë.

Sa i përket pretendimit të përfaqësuesit të paditurës se kërkesëpadia e paditësve duhet të refuzohet për faktin se palët nënshkruese të Kontratës Kolektive nuk i kanë derdhur mjetet financiare të zotuar me këtë kontratë dhe e paditura nuk ka mjete financiare që ti përmbushë këto detyrime ndaj paditësve, këto pretendime për gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me dispozitën e lartëcekur të nenit 46 palët nënshkruese të kësaj Kontrate kanë vetëm rol informues dhe lehtësues për komunat e Kosovës në përmbushjen e Kontratës Kolektive e jo rol financues, andaj, në këtë rast, e paditura është e obliguar drejtpërdrejtë që ta zbatojë këtë Kontratë Kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin dhe të siguroj mjete financiare për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kontrata në fjalë, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuar për këto raste, andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek palët nënshkruese të Kontratës Kolektive.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykata duke u bazuar në nenin 452 par.1 të LPK-së e ka obliguar të paditurën që paditësve t’ua paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 269.20 € dhe atë si në vijim: për përpilim të padisë shumë prej 104.00 €, për taksën gjyqësore shumë prej 40.00 € dhe përfaqësim të avokatit në një seancë në shumë prej 135.20 €.

Gjykata i ka obliguar paditësit paraprakisht që të bëjnë pagesën e taksës gjyqësore për paraqitje të padisë në shumë prej 20.00 €, konform nenit 12 par.1 të UA nr.01/2017 të KGJK-së për unifikimin e taksave gjyqësore.

Andaj, nga arsyet e lartë cekura, konform nenit 143 të LPK-së, lidhur me nenin 35 pika 7 dhe 8 dhe nenin 46 të Kontratës Kolektive për Arsim Parauniversitar e vitit 2017, si dhe nenit 382 par.2 i LMD-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.2022:247245 me datë 01.07.2024

**Gjyqtari,
Bekim Salihu**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.